

UDHËZIM
Nr. 20, datë 1.9.2023

**PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRËS DHE PROCEDURËS SË PUNËSIMIT ME
PRIORITET TË MJEKËVE QË PËRFITOJNË TRAJTIM TË VEÇANTË NË
INSTITUCIONET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6, të ligjit nr. 60/2023, “Për trajtimin e veçantë të studentëve që ndjekin programin e integruar të studimit të ciklit të dytë ‘Mjekësi e përgjithshme’ në institucionet publike të arsimit të lartë”,

UDHËZOJMË:

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

1. Ky udhëzim rregullon mënyrën dhe procedurën për punësimin me prioritet të mjekëve që përfitojnë trajtim të veçantë, në institucionet shëndetësore, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Procedura për punësimin me prioritet dhe emërimin në një vend të lirë pune në institucionet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë realizohet nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionet e saj të varësisë, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Mjekët që punësohen me prioritet përjashtohen nga procedurat konkurruese të parashikuara në udhëzimin përkatës të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

Neni 2

Përgjegjësitë e institucioneve

1. Ministria e Arsimit dhe Sportit ka përgjegjësitë si më poshtë:
 - a) bashkëpunon me Universitetin e Mjekësisë, Tiranë për të mundësuar kalimin zyrtarisht ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, të diplomës dhe suplementit të saj të studentit të sapodiplomuar në programin e ciklit të dytë të studimeve “Mjekësi e Përgjithshme”, që ka nënshkruar marrëveshjen me Universitetin e Mjekësisë Tiranë, ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë;
 - b) bashkëpunon me Universitetin e Mjekësisë, Tiranë për t’i kaluar zyrtarisht Urdhrit të Mjekëve një kopje të njehsuar të diplomës dhe suplementit të saj të studentit që ka nënshkruar marrëveshjen, me qëllim pajisjen me lejen e ushtrimit të profesionit të mjekut, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.
2. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka përgjegjësitë si më poshtë:
 - a) vlerëson nevojat, identifikon dhe përditëson çdo vit dhe në mënyrë dinamike, listën e vendeve vakante për pozicionin “mjek i përgjithshëm” në institucionet shëndetësore, me qëllim punësimin me prioritet të mjekëve të sapodiplomuar;
 - b) organizon procedurën për njoftimin për vendet e lira të punës dhe punësimin e këtyre mjekëve, sipas nevojave të sistemit shëndetësor;
 - c) pas procedurës për njoftimin e emërimit të mjekut, dërgon diplomën me suplementin në institucionin shëndetësor ku punësohet, për t’u administruar në dosjen personale të mjekut, sipas dispozitave ligjore në fuqi;
 - d) dërgon çdo vit pranë Urdhrit të Mjekëve listën e studentëve që kanë nënshkruar marrëveshjen me Universitetin e Mjekësisë Tiranë, ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe ministrinë përgjegjëse

për shëndetësinë, sipas afateve të parashkruara në këtë marrëveshje mes palëve, që hyn në fuqi pas licencimit të tyre si mjek dhe fillimit të punësimit me institucionin shëndetësor sipas nevojave të sistemit shëndetësor, si dhe listën e mjekëve të punësuar bazuar në këtë marrëveshje;

e) me përfundimin e angazhimit të punësimit të mjekut, për periudhën kohore të parashikuar në marrëveshjen mes palëve, institucioni shëndetësor i dorëzon atij diplomën dhe suplementin origjinal, dhe administron në dosjen e tij individuale kopjen e njehsuar të këtij dokumentacioni.

Neni 3

Procedura për punësimin me prioritet të mjekut

1. Pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë ngrihet komisioni *ad-hoc*, i cili organizon dhe ndjek procedurën e punësimit të mjekëve të sapodiplomuar, bazuar në rezultatet e studimeve të tyre universitare, vendlindjen/vendbanimin dhe pozicionet vakante në institucionet shëndetësore në vend.

2. Struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë njofton mjekun për emërimin dhe institucionin shëndetësor ku ai emërohet.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Universiteti i Mjekësisë Tiranë dhe Urdhri i Mjekëve.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi